



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

V E N D I M

Nr. 9, datë 17.04.2025

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZONJËS NURIHAN META (SEITI) NË
VENDIN VAKANT, MANDAT PLOTËSUES, PËR GJYQTAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË MË DATË 30.09.2024**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryetar
Marjana Semini	Zëvendëskryetare
Ilir Toska	Anëtar
Alma Muça	Anëtare
Elvana Çiçolli	Anëtare zëvendësuese
Enkela Vlora	Anëtare
Irma Balli	Anëtare
Etjen Kapo	Anëtar
Nafije Hasko	Anëtare relatore

Asistuar nga sekretare Fabjola Muhameti, me praninë e Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: zonjës Evis Fico përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit; në mungesë të përfaqësuesve të autorizuar të Presidentit të Republikës, z. Ilir Rusmajli dhe znj. Fiorida Ballauri, dijeni kanë pasur rregullisht sipas ligjit; në mbledhjen e datës 27.03.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Nurihan Meta (Seiti)

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30.09.2024.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED-it, zonjës Nafije Hasko, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”* (në vijim ligji nr. 8577/2000), Kuvendi i Shqipërisë, në datën 30.09.2024, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, e cila, është përcaktuar vakancë e pjesshme, e krijuar për shkak të deklarimit të mbarimit përpara afatit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese znj. Elsa Toska.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i Shqipërisë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, ndër të tjerët edhe kandidaten Nurihan Meta (Seiti).

3. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit nr. 2, datë 15.02.2019 të KED, si edhe të pikës 4 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 të KED *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, në mbledhjen së zhvilluar në datën 01.11.2024, është realizuar edhe procedura për caktimin me short elektronik të relatorit për vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, si dhe caktimin me short manual të këshilltarit ligjor që do të ndihmojë relatorin në kryerjen dhe ndjekjen e procedurave administrative të verifikimit.

4. Sipas rezultatit të shortit elektronik të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 01.11.2024, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Irena Brahimi, ndërsa këshilltar ligjor znj. Aulona Bodo.

5. Për shkak të përfundimit të mandatit 1 vjeçar të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të vitit 2024, kjo vakancë i kaloi për shqyrtim përbërjes së re të KED të viti 2025. Në këto kushte në datë 15.01.2025 u realizuar përsëri procedura e shortit për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja Nafije Hasko, ndërsa si këshilltar ligjor Znj. Aulona Bodo.

6. Sipas përcaktimeve të vendimit nr. 4, datë 11.3.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të cilin pasqyrohet se, “Kur veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit nuk kanë përfunduar gjer më 31 dhjetor, **atëherë relatori i ri kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera për të përfunduar me përparësi këtë fazë, duke konsideruar respektimin e afatit ligjor**”, si dhe pikës 5/2 të po këtij vendimi, në të cilin pasqyrohet se, “Kur relatori i ka përfunduar veprimet procedurale dhe verifikuese, por Këshilli nuk ka shqyrtuar çështjen gjer më 31 dhjetor, atëherë relatori i ri, pasi kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera: a) konfirmon procedurën e ndjekur dhe përcjell relacionin e hartuar prej tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit; b) vijon kryerjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese shtesë”, relatorja e re znj. Nafije Hasko, ka vlerësuar të vijojë procedurën verifikuese në fazën në të cilën është ndërprerë, duke konfirmuar veprimet e kryera deri në këtë moment.

7. Në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar; si dhe Vendimin nr. 4, datë 11.3.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 17.01.2025, kandidates Nurihan Meta (Seiti) i është njoftuar konstituimi i përbërjes së KED për vitin 2025, si dhe emri i relatores që do të trajtojë këtë vakancë ku ajo ka shfaqur interes për kandidim, si dhe këshilltarin ligjor së caktuar rishtazi.

II. Informacion mbi ecurinë e procedurës së verifikimit të kandidaturës

8. Znj. Nurihan Meta (Seiti), si një nga kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar, është njoftuar nëpërmjet rrugës elektronike në datë 07.11.2024, për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim datë 07.11.2024, është kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, i cili gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

9. Në datën 08.11.2024, kandidatja Nurihan Meta (Seiti) është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ka tërhequr formularët e deklaratave,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

autorizimeve dhe informacioneve të përcaktuara sipas ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar.

11. Në datën 08.11.2024, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, nëpërmjet formës elektronike të njoftimit (i cili është i administruar në dosje), ka njoftuar kandidaten Nurihan Mete (Seiti) në lidhje me: “...Dëshirojmë t’Ju bëjmë me dije se adresat zyrtare të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të hostuara pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Ky institucion, pas sulmit kibernetik të ndodhur në vitin 2022 ka ndërmarrë disa hapa sigurie për filtrimin e adresave elektronike postare. Pjesë e kësaj strategjie filtrimi është edhe pamundësia e komunikimit nga adresa jozyrtare kundrejt adresave tona zyrtare. Gjendur në këtë situatë, me miratimin e Kryetarit të KED, z. Sokol Ngresi, si dhe në ardhjen në ndihmë të korrespondencave tona, janë krijuar 2 adresa të tjera; konkretisht: keshilltarked@gmail.com; sekretariaked@gmail.com; Ju sjellim në vëmendje se për çdo komunikim tuajin drejt KED-së, jeni të lutur të drejtoheni në adresat e sipërcituara....”.

12. Bazuar sa më sipër, e gjithë korrespondenca gjatë procedurës së verifikimit është mbajtur normalisht në adresat e sipërcituara.

13. Në datën 12.11.2024, kandidatja Nurihan Meta (Seiti) është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të depozituar autorizimet, deklaratat dhe formularët e nënshkruar prej saj, sipas kërkesave të përcaktuara në ligj. Për këtë arsye, është mbajtur edhe proces-verbali me nr. 74 Prot., datë 12.11.2024 sipas të cilit janë pasqyruar në mënyrë të detajuar: (i) autorizimet përkatëse të nënshkruar nga kandidati dhe personat e lidhur me të; (ii) deklaratat e nënshkruara nga kandidati; (iii) formulari i vetëdeklarimit për pozicionet drejtuese të mbajtura në parti politike nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit për vitin 2024; (iv) deklarata për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike të KED; (v) Deklaratë për paraqitjen në Zyrën e KED dhe tërheqjen e autorizimeve; (vi) Vërtetim i datës 11.11.2024 i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (vii) Vërtetim i lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (viii) Vërtetim i lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

14.. Në datën 27.11.2024, kandidatja Nurihan Meta (Seiti) është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ka depozituar me cilësinë e dokumentacionit provues këto akte: (i) Jetëshkrimin (CV) sipas formatit të miratuar nga KED; (ii) Vërtetim të njëzuar me origjinalin me nr. 1838 Rep., datë 27.11.2024 lëshuar nga noteri Genci Duraj; (iii) kontratë pune e datës 18.02.2012 nga Akademia Profesionale e Biznesit; (iv) Dokumenti “Struktura dhe Buxheti i Institucioneve të Reja të Sistemit të Drejtësisë” Tiranë 24 Prill 2018, me praninë e Ambasadorëve në Republikën e Shqipërisë; (v) Rendi i Ditës Këshilli i Lartë i prokurorisë, Seminar mbi Menaxhimin për Anëtarët Jo-Prokuror Korrik 17-20 Korrik 2018; (vi) Consultative Meeting Setting Up

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

Justice Governance Institutions 24 Prill 2018; (vii) Kurs Trajnimi Kaskadë mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut Tiranë 21-22 Prill 2008. Për dorëzimin e këtyre dokumenteve shkresorë është mbajtur proces-verbali i marrjes në dorëzim të dokumenteve me nr. 99 Prot., datë 27.11.2024.

III. Ecuria e procedurës pranë ILDKPKI, lidhur me kriterin e verifikimit pasuror

15. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si pikës 60 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 të KED “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, nëpërmjet shkresës me nr. 98 Prot., datë 26.11.2024, i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

16. Me shkresën e datës 3255/3 Prot., datë 18.12.2024, ILDKPI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se: “...Në vijim të shkresës suaj nr. 98 Prot, datë 26.11.2024, lidhur me listën e kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, ju bëjmë me dije se ILDKPKI ka marrë të gjitha masat dhe ka vënë në dispozicion strukturat dhe burimet e nevojshme njerëzore, për kryerjen në kohë të procesit të plotësimit, dorëzimit dhe administrimit të deklaratave të pasurive dhe interesave privatë, si dhe dokumentacionit përkatës. Nga verifikimi i listave dhe datës së shprehjes së interesit nga kandidatët, ju bëjmë me dije se: 1. Kanë dorëzuar brenda datës 12.12.2024, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, Udhëzuesin “Mbi Plotësimin e Dokumentit Zyrtar, Deklarata e Pasurisë dhe Interesave Privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, si dhe Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 927, datë 1.11.2021 “Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të Deklaratave të Pasurisë dhe Interesave Privatë në formë elektronike në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesit (EACIDS), i ndryshuar, Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, kandidatët: ...5. Nurihan Meta”.

17. Me shkresën nr. 3255/7 Prot., datë 27.02.2025, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Interesave Private ka përcjellë Aktin e Përfundimit të Kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit për pozicione të sistemit të drejtësisë, znj. Nurihan Meta (Seiti), për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese”, me nr. 231/23 Prot., datë 27.02.2025, në të cilin ka arritur këto rezultate: “...Në përfundim të kontrollit të plotë rezultoi:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e realizuara nga kandidati gjatë periudhës së punësimit, gusht 1999 - qershor 2010 dhe janar 2014 - janar 2019, si dhe gjatë periudhës së zhvillimit të aktiviteteve private si Person

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Fizik, me NIPT K783262011, nga dt. 26.9.2007 deri në dt. 8.7.2008, dhe NIPT L52102076P nga data 02.09.2015 deri në datë 23.11.2018, ku nuk deklarohen/konfirmohen të ardhura.

- Mospërputhje të deklarimeve të kandidatit dhe të pambështetura me dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e realizuara ndër vite, të cilat kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të konsumit familjar. Kandidati deklaroi të ardhura nga shitja e apartamentit në vitin 2003, në vlerën 32.000 euro, por referuar dokumentacionit, vlera e të ardhurave ka qenë 1.950.000 lekë, vlerë e cila nuk ka mjaftuar për blerjen e njësisë 22.000 USD dhe për rrjedhojë është e pamundur të ketë pasur tepriçë fondesh.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me mundësitë financiare të kandidatit dhe b/shortit, për shlyerjen e apartamentit me sip. 94.98 m², në Rr. "Shyqyri Bërxolli", Tiranë, në favor të subjektit Inter Co-Sat sh.p.k., gjatë viteve 2015-2018, në shumën 41.000 euro, si dhe gjatë periudhës 01.01.2020 - 29.02.2020, në shumën 10.000 euro.
- Mospërputhje e deklarimeve, në deklaratën e kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë me deklaratimet e interesave private ndër vite të subjektit Nurihan Meta, lidhur me apartamentin me sip. 94.98 m², sa i përket vlerës së financimit përfituar me klering, pjesës që do likuidohet nga ortakët e shoqërisë Inter Co-Sat sh.p.k., si dhe kësteve të paguara.
- Mospërputhje e periudhës kronologjike, lidhur me përfitimin e pasurisë apartament me sip. 94.98 m², ku rezulton se raporti financiar nga shërbimet e avokatisë ka filluar në dt. 30.3.2012, me kontratën e porosisë, përfunduar me akt marrëveshjen në dt. 24.7.2015, ndërsa faturat tatimore, janë lëshuar nga personi fizik Hazis Meta, me NIPT L81414014E, në muajin mars 2018, në vlerën prej 100.700 euro, detyrimet e të cilave nuk janë deklaruar në fund të vitit përkatës ushtrimor, por në vitin 2021.
- Kandidati nuk ka sqaruar dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me qëllimin e nënshkrimit nga bashkëshorti, të deklaratës nr. 1585 Rep., nr. 625 Kol/1, datë 20.07.2015, me shtetasin Arian Muco dhe përfitimin e shumës 15.000 euro prej tij. Përveç kësaj, deklaruesit i referohen dokumenteve noteriale, që nuk vijnë në rrjedhë datash kronologjike.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me periudhën e qëndrimit të kandidatit familjarisht në banesën e motrës së saj, nga shitja e apartamentit në Tiranë në shkurt 2003 deri sa kanë hyrë në apartamentin në Rrugën "Shyqyri Bërxolli", sipas kandidatit, në janar 2019.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me mundësitë financiare të kandidatit dhe b/shortit, për dhënien e huas në shumën 18.000 euro, datë 15.05.2007.
- Mospërputhje të deklarimeve të kandidatit Nurihan Seiti në deklaratën "Para fillimit të detyrës 2018", Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit, si dhe dokumentacionit të paraqitur, lidhur me mënyrën e shlyerjes së

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

pasurive apartament me sip. 63.93 m2+ garazh me sip. 19.33 m2 dhe shumën totale të paguar për këto pasuri.

- Gjithashtu, rezulton se vlera e apartamentit me sip. 63.93 m2, prej 27.037 euro, është nën vlerën referencë të tregut të shitblerjes së pasurive të paluajtshme dhe nën vlerën e përcaktuar në kontratën e huadhënies, datë 15.05.2007, si dhe çmimi i tij për m2 (423 Euro/m2), është sa gjysma e çmimit për m2 të garazhit (875 Euro/m2), fakt që nuk përputhet me çmimet e shitblerjes së pasurive të paluajtshme.
- Mospërputhje e periudhës kronologjike, lidhur me përfitimin e pasurisë apartament me sip. 63.93 m2, ku rezulton se raporti financiar nga shërbimet e avokatisë ka filluar në dt. 15.5.2007 me kontratën e huadhënies, përfunduar me kontratën e sipërmarrjes në dt. 10.9.2015, ndërsa fatura tatimore është lëshuar nga personi fizik Hazis Meta me NIPT L81414014E, në muajin mars 2018, në vlerën prej 25.000 euro, detyrimet e të cilave nuk janë deklaruar në fund të vitit përkatës ushtrimor, por në vitin 2021.
- Mosdeklarim i të drejtave dhe detyrimeve financiare të djalit Rei Meta, mbi pasurinë e paluajtshme apartament me sip. 60 m2 dhe likuiditeteve financiare 14.000 euro, referuar kontratës së sipërmarrjes nr. 394 Rep., nr. 128 Kol., datë 22.04.2020, si dhe deklaratës noteriale datë 22.04.2020, si dhe mosdeklarim i të drejtave mbi shtesën prej 30 m2, në apartamentit ekzistues, referuar deklaratës noteriale dt. 30.6.2022.
- Mungesë dokumentacioni i pjesshëm justifikues, për shpenzimet e arsimit të fëmijëve në vlerën rreth 30.000 USD, me burim të ardhurat familjare, të cilat rezultojnë të pamjaftueshme për përballimin e tyre.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me qëllimin e kryerjes së transaksioneve financiare nga kandidati ndër vite, pranë RFZ Bank, BKT, Credins Bank.
- Kandidati nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë, depozitën në BKT, me vlerë 151.792 lekë, gjendje në datë 12.12.2024.
- Mospërputhje e deklaramit në organet tatimore të b/shortit të kandidatit, për aktivitetin e tij si person fizik, me NIPT K78326202Q sa i përket qarkullimit dhe fitimit, në shumat 850.000 lekë dhe 333.000 lekë, për vitin 2008, në një kohë që vetëm nga një vlerë e kredituar në llogarinë personale të tij prej 2.003.714 lekë, në datë 06.03.2008, për shërbime avokatore, 1.000.000 lekë është pjesa e përfituar prej tij.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me mundësitë financiare familjare, për blerjen e automjetit M. Benz, nga Haziz Meta, me vlerë 900.000 lekë, në vitin 2012.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, Ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 115/2016, datë 3.11.2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Vendimin nr. 4, datë 11.3.2019 të KED, konstatohet se për kandidatin Nurihan Meta;

- a) **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.**
- b) **ka mosdeklarime dhe burime të pjesshme financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;**
- c) **nuk ka kryer fshehje të pasurisë;**
- d) **nuk ka kryer deklarim të rremë;**
- e) **nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave....**”.

18. Në datën 04.03.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nëpërmjet rrugës elektronike i ka njoftuar kandidates Nurihan Meta (Seiti) Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë me nr. 231/23, datë 27.02.2025 të përcjellë nga ILDKPKI, duke i bërë me dije se: “....ILDKPKI, me shkresën nr. 3255/7prot, date 27.02.2025 ka dërguar pranë KED, Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë me nr. 231/23, datë 27.02.2025, për kandidaturën tuaj. ILDKPKI, lidhur me periudhën e verifikuar ka ardhur në përfundimin se:

- Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- Ka mosdeklarime dhe burime të pjesshme financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- Nuk ka kryer fshehje të pasurisë,
- Nuk ka kryer deklarim të rremë,
- Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Në zbatim të nenit 229 pika 2 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 26, 66, 67 dhe 68 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, keni të drejtën që, brenda një afati 5 ditor nga ky njoftim të paraqisni shpjegime me shkrime dhe eventalisht dokumente mbështetës drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë.

Nëse vlerësoni se keni të nevojshme të konsultoheni me Aktin e Kontrollit të ILDKPKI, mund të paraqiteni në kohën më të shpejtë të mundshme pranë zyrave të Këshillit, gjithsesi bashkëlidhur gjendet dhe kopja e skanuar.

Lutemi të konfirmoni marrjen dijeni të këtij njoftimi në të njëjtën adresë elektronike të këtij komunikimi ...”.

19. Në datën 07.03.2025, kandidatja Nurihan Meta (Seiti), është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke paraqitur shpjegimet e saj me shkrim në lidhje me konkluzionet dhe gjetjet e pasqyruara në Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë me nr. 231/23, datë 27.02.2025 të ILDKPKI, për të cilin, është mbajtur edhe proces-verbali i marrjes në dorëzim të dokumenteve me nr. 174 Prot., datë 07.03.2025. Në këto shpjegime të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

depozituara nga ana e kandidatës Nurihan Meta (Seiti), është mbajtur qëndrimi se: “...Në detyrimin Ligjor mbi origjinën e burimeve të mia financiare familjare që nga shtatori i vitit 1987, përpara se të jap shpjegimet e mia Deklaroj: Për rreth 20 vite unë dhe familja ime nuk kemi qenë asnjë moment subjekt deklarimi. Përherë të parë Subjekt Deklarues jemi bere ne Vitin 2018 kur mora detyrën si Anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kur Dorëheqjen time si prokurorë e kisha vendosur në vitin 1991.

- Jam Kontrolluar për Deklarimet e mia në Vitin 2022 nga ILDKPI. Në përfundim të kontrollit me njoftuan se kisha mangësi në tatim taksa për Aktet e Bashkëshortit tim me Firmat Ndërtuese ku do funksiononte kleringu për punën e kryer
- Kam paguar rreth 18.000 Euro (Tetëmbëdhjetë mijë Euro taksa dhe tatime) dhe kam paraqitur të gjitha faturat rreth 250 fatura në ILDKPI.
- Pas këtyre pagesave dhe akteve të punës së bashkëshortit qam munda ta merrja dhe nga Noteri Grek, nuk jam njoftuar për asnjë të metë.
- Nga viti 1967- Gusht 1999 qe kam punuar si Prokurorë ne Qytetin e Fierit te ardhurat e mia kane qenë paga ime dhe një pjesë financiare pune dhe emigrimi i bashkëshortit për të cilat ka dhënë shpjegimet e tij.
- Për gati 20 vite unë duke mos pasur asnjë detyrim jo vetëm ndaj të tretëve por edhe në rritjen e fëmijëve, të cilët shkonin në kopsht dhe shkolla shtetërore . . . dhe për banesën në Fier nuk kishim qira se u privatizua, kam krijuar fond të mjaftueshëm dhe rezervë financiare edhe për të ardhmen aq sa mund të arrija!
- Në Dhjetor të vitit 1998 kam marrë licencën nr. 817 dhe jam angazhuar në gjithë aktivitetin tim gati 15 vjeçar vetëm Part Time si Avokate, asnjëherë nuk kam punuar Full Time.
- Në punën time me bankë për herë të parë jam paguar rreth vitit 2008 nga Fakulteti Motrat Qiriazi dhe Fakulteti Vitrinat ku jepja Leksione!
- Në kohë kaq shumë të gjatë për mbi dy dekada me kërkohen veprime të kryera nga qytetarë që sot janë ndarë nga jeta duke qenë qartësisht e dukshme në aktet që kam paraqitur veprimi i tyre!
- Kam paraqitur çdo provë të cilat janë dëshmi provueshmërie për financat e mia!
- Në 20 vite nuk kam nënshkruar kurrë Deklarata Detyrimi të hollash, të kem patur ndonjë proces gjyqësor civil penal apo po detyrime të tjera!
- Subjekti i deklarimit znj. Nurihan Meta
- Lidhur me konstatimin mbi: "**Mospërputhje të deklarimeve dhe të pambështetura me dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e realizuara ndër vite, të cilat kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të konsumit familjar. Kandidati deklaroi të ardhura nga shitja e apartamentit në vitin 2003 në vlerën 32.000 Euro, por referuar dokumentacionit vlere e të ardhurave ka qenë 1.950.000 lekë, vlere e cila nuk ka mjaftuar për blerjen e njësisë 22,000 USD dhe për rrjedhojë është e pamundur të ketë pasur teprice fondesh"**
Deklaroj se në vitin 2003, sipas Ligjit të asaj kohe, çdo transaksion mbi 2,000,000 lek, kishte një tatim prej 1% dhe për shkak se ne si palë shitëse kishim dakortësuar vlerën prej 32,000 Euro Neto për shitjen e apartamentit, taksat e gjeneruara mbi ketë transaksion do të paguheshin nga pala blerëse. Në këto kushte, në mënyrë që

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

vlera e negociuar nga ana jone mos të ndryshohej, pala blerëse ka kërkuar që ky transaksion të shënohej më pak dhe në këtë mënyrë do të paguante dhe më pak taksa. Nga këto të ardhura, 20,000 USD kanë kaluar për blerjen e zyrës dhe diferenca ka shërbyer për shpenzimet familjare. Pavarësisht, gjatë kësaj periudhe, b/shorti ka krijuar të ardhura nga emigracioni. Unë kam punuar pranë Shoqërisë "Letër Karton" e cila është e vërtetueshme nëpërmjet borderove të lëshuara nga Shoqëria. Sot kjo shoqëri nuk ekziston dhe nuk mund të disponoj asnjë dokumentacion.

Gjithashtu, deklaroj se në periudhën Gusht 1999. Dhjetor 2005, kam punuar pranë Shoqërisë "Letër Karton me Administrator Znj. Merita Kosova dhe konsulente pranë disa OJF-ve të ndryshme të asaj kohe si "Shoqata e Ndihmës për Punonjësit e larguar nga Puna" me drejtuese znj. Afërdita Daja dhe tek "Shoqata e Prindërve Mësuesve dhe Nxënësve me drejtues z. Tom Tresa dhe z. Shefqet Hysi

Konsulencat dhe të ardhurat i kam deklaruar në të gjitha Deklaratat e Pasurisë nga viti 2018, ku jam pyetur nga ILDKPKI në atë kohë dhe më është konfirmuar që deklarimi është i sakte dhe merret për bazë vlerësimi. Pagesat janë kryer cash nga këto institucione dhe jo nëpërmjet bankës. Këtë fakt nuk mund ta mohoj pasi janë vite pune të cilat nëpërmjet dëshmitarëve të institucioneve të asaj kohe, vërtetohet që kam qenë pjesë kryesore e konsulencave juridike. Pagesat pranë këtyre institucioneve shkonin nga 300 USD deri më 1500 USD në muaj në varësi të shërbimit të konsulencës që ofroja. Duke qenë se punoja part time, jam vënë në dijeni me vonesë që sigurimet shoqërore nuk më janë paguar dhe jam gjendur përball këtij fakti pas shumë kohësh kur këto institucione nuk ekzistonin më. Për këtë arsye, jam detyruar ti paguaj personalisht.

Në vitet 2000-2002, kam punuar pranë një zyre noterie gjithashtu, nga ku dhe aty pagesën e merrja cash për çdo konsulencë juridike që kryeja pranë kësaj zyre.

- **Lidhur me konstatimin mbi: "Mundësitë financiare të kandidatit dhe b/shortit, për shlyerjen e apartamentit me sip.94.98 m2, në Rr. "Shyqyri Bërxolli", Tiranë, në favor të subjektit InterCo-Sat sh.p.k., gjatë viteve 2015-2018, në shumën 41,000 euro si dhe gjatë periudhës 1.1.2020-29.02.2020 në shumën 10,000 euro".**

Deklaroj se apartamenti me sipërfaqe 94.98 m2, me adresë rruga "Shyqyri Bërxolli", është përfituar sipas akt marrëveshjes ndërmjet palës HIMI sh.p.k me administrator Z. Arjan Muco dhe Interco-Sat me administrator Z. Sali Xhebrahimi dhe b/shortit Z. Hazis Meta, mbi mbrojtjen ligjore që b/shorti ka kryer në Gjykatën e Shkallës së Parë ndaj kompanisë dhe pronarëve të tokës referuar dhe prokurës së lëshuar nga familja Hoxholli (Petrir Hoxholli), nga ku nëpërmjet shërbimeve avokate të kryera, është përfituar sipërfaqja në fjalë, ku nga ana e b/shortit janë paguar vetëm 61,000 Euro. Këto të ardhura janë siguruar nga puna e b/shortit si emigrant, kursimet e mia familjare dhe kredi bankare të marra gjatë këtyre periudhave.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- ***Lidhur me konstatimin mbi: “Është e pa dokumentuar periudha e qëndrimit të kandidatit, familjarisht, në banesën e motrës së saj, për periudhën nga shitja e apartamentit në Tiranë në shkurt 2003, derisa kanë hyrë në apartamentin në rrugën "Shqyri Bërxolli", sipas kandidatit, në janar 2019”.***

Deklaroj se nga viti 2003 deri në Dhjetor 2018, kam jetuar në shtëpinë e motrës sime Znj. Violeta Qibini dhe b/shortit të saj Z. Luan Qibini. Këta persona kanë jetuar në Greqi gjatë kësaj periudhe dhe për këtë arsye është dakortësuar që të jetoj aty familjarisht duke mirëmbajtur dhe ndërtuesen njëkohësisht. Në këtë ndërtesë nuk kam paguar qira ose detyrime të tjera ndaj motrës sime. Ndërtesa ka qenë një shtëpi private 3 kate, me oborr, në rrugën "3 Vëllezërit Kondi", pranë Shkollës Franko-Shqiptare "Viktor Hygo". Kjo godinë ka qenë pa dokumentacion përkatës për shkak se zona ka qenë informale dhe e paazhurnuar në sistemin e kadastrës. Posedimi i kësaj ndërtese vërtetohet nga pagesat mujore të energjisë elektrike dhe ujësjellës kanalizime, Jetesa në këtë ndërtesë vërtetohet gjithashtu duke marrë deklarime dhe nga komshinjtë kufitar si prsh: Alfred Seiti, Malo Malaj etj. Banesa e sime motra është certifikuar vitet e fundit pas azhurnimit të zonës.

- ***Lidhur me konstatimin mbi: “Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor me mundësitë financiare familjare, për blerjen e automjetit M.Benz nga Hazis Meta, me vlerë 900,000 në vitin 2012”.***

Deklaroj se për automjetin e blerë në vlerën 900,000 lek, detyrimi nuk është likuiduar i plotë në momentin e firmosjes së kontratës. Në momentin e firmosjes së kontratës janë likuiduar 100,000 lekë dhe më pas janë likuiduar në mënyra periodike pjesore për një periudhe 5 vjeçare. Likuidimi total i automjetit është kryer në vitin 2017, për shkak se pala shitëse është marrëdhënie krushqie me kandidatin.

- ***Lidhur me konstatimin mbi: “Kandidati nuk ka sqaruar dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me qëllimin e nënshkrimit nga bashkëshorti, të deklaratës nr. 1585 Rep, nr. 625 Kol/1, datë 20.07.20215, me shtetasin Arian Muço dhe përfitimin e shumës 15,000 euro prej tij. Përveç kësaj, deklaruesit i referohen dokumenteve noteriale, që nuk vijnë në rrjedhë datash kronologjike”.***
- ***Qëllimi i firmosjes së marrëveshjes për vlerën 15.000 euro, ka shërbyer si njohje detyrimi nga shoqëria HIMI sh.p.k, e cila do të merrte përsipër zhvillimin e pronës. Shoqëria HIMI sh.p.k ka kaluar më pas të drejtat dhe detyrimet te kompania InterCo-Sat sh.pk për të vijuar me zhvillimin e pronës dhe paralelisht është kryer dhe marrëveshja e vlerës 15,000 euro me administratorin e kësaj kompanie. Për shërbimet juridike të ofruara ndaj këtyre kompanive, është përfituar kjo vlerë e konvertuar në sipërfaqe metrash katror në objektin që do të ndërtohej. Përpilimi i kësaj marrëveshje është sugjeruar nga pala ndërtuese. I ndodhur përball këtyre kushteve, bashkëshorti ka vendosur të veprojë sipas propozimit të kompanisë.***
- ***Lidhur me konstatimin mbi: “Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me mundësitë financiare të kandidatit dhe b/shortit, për dhënien e huas në shumën 18.000 euro datë 15.5.2007”.***

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Deklaroj se kjo marrëveshje ka shërbyer për të njohur nga ana e huamarrësit shërbimet juridike që ka kryer për favor të shoqërisë kundrejt dhe pronarëve të tokës. Theksoj se, bashkëshorti nuk e ka dhënë asnjëherë këtë vlerë, por në mënyrë që të njihej shërbimi ofruar nga ana e tij, është detyruar nga pala ndërtuese të përpiloj dhe të dakordësoj një marrëveshje të tillë. Në këtë mënyrë, duke i njohur dhe deklaratën e borxhit e cila në vetvete ka të bëjë me shërbimin juridik që i ka ofruar kompanisë, ai ka përfituar pjesën e tij takuese të ofruar nga kompania dhe pronarët faktik të tokës gjatë kësaj periudhe. Çështjet gjyqësore që ka përfaqësuar kanë qenë për saktësim prone nga ku disponohen dhe vendimet respektive.
- Lidhur me konstatimin mbi: **“Mungesë dokumentacioni i pjesshëm justifikues, për shpenzimet e arsimit të fëmijëve në vlerën rreth 30,000 USD, me burim të ardhurat familjare, të cilat rezultojnë të pamjaftueshme për përballimin e tyre”**. Deklaroj se shpenzimet prej 30,000 USD për shkollimin e fëmijëve janë siguruar nga të ardhurat e emigracionit të bashkëshortit tim.
- Lidhur me konstatimin mbi: **“Mospërputhje e deklaramit në organet tatimore të b/shortit të kandidatit për aktivitetin e tij si Person Fizik, me NIPT K783262020, sa i përket qarkullimit dhe fitimit, në shumat 850,000 lekë dhe 333,000 lekë, për vitin 2008, në një kohë që vetëm nga një vlerë e kredituar në llogarinë personale të tij, prej 2.003.714 lekë, në datë 06.03.2008, për shërbime avokatore, 1.000.000 lekë është pjesa e përfituar prej tij”**. Deklaroj se bashkëshorti e ka përfituar këtë vlerë për shërbimet avokatore të kryera, vlerë të cilën pala ja ka dhënë në mënyrë periodike vjetore për një afat 5 vjeçar. Faturat janë prerë konform legjislacionit tatimor në fuqi, pavarësisht se nuk janë deklaruar plotësisht në ILDKPKI,
- Sa më sipër, deklaroj me bindjen dhe përgjegjësinë time të plotë se të gjitha burimet e të ardhurave për të kryer jetesën normale si çdo familje tjetër Shqiptare, janë të ligjshme dhe të faktuara. Organizimi, kursimi apo shpenzimi i kryer nga familja ime është mëse e kalkuluar në mënyrë kronologjike dhe brenda të gjitha kufijve të plotësimit të standardit mesatar të jetesës.
- Në angazhimin tim si qytetarë e këtij vendi, nuk ka asnjë dyshim për veprimtari të jashtëligjshme mbi ekonominë e ndërtuar këto vite, pasi dhe vet institucioni ILDKPKI gjatë viteve 2018-2023 që unë kam deklaruar normalisht, ka kryer kontrollin periodik gjatë ushtrimit të funksionit tim dhe nuk ka konstatuar kurrë asnjë problem mbi lëvizjet monetare të mia apo familjes sime.”.

IV. Njoftimet dhe paraqitja e relacionit për Mbledhjen e KED

20. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 27.03.2025, ora 15:30, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimi i gjetjeve për kandidaten zonjën

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Nurihan Mete (Seiti), për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë, në datën 30.09.2024.

21. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates znj. Nurihan Meta (Seiti).

22. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

23. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 27.03.2025, ora 15:30, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

24. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

25. Në mbledhjen e datës 27.03.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi u njoh me relacionin e hartuar nga relatori dhe komunikuar kandidatit dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit, ka evidentuar faktin se në këtë relacion, nuk ishte pasqyruar qëndrimi konkret i relatorit në lidhje me gjetjet e konstatuara nga ILDKPI sa i takon kriterit të vlerësimit dhe kontrollit të pasurisë. Për këtë arsye, Këshilli ka arritur në konkluzionin se pa u parashtruar në mënyrë të qartë, të përmbledhur dhe të arsyetuar propozimi i relatorit të çështjes në lidhje me zgjidhjen konkrete të saj dhe vijimësisë së procedurës së verifikimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk mund të procedonte me marrjen e një vendimi përfundimtar.

26. Për këtë arsye, ju la detyrë relatorit të vakancës që të draftonte dhe ti komunikonte kandidates qëndrimin në lidhje me gjetjet e konstatuara, analizimin dhe sqarimin e parashtrimeve të dhëna nga kandidati, si dhe propozimin konkret të tij, në lidhje me vijimësinë e procedurës së verifikimit si dhe zgjidhjen e çështjes që do ti adresohet për vendimmarrje Këshillit në lidhje me ndalimin e kandidimit të kandidates Nurihan Meta (Seiti) apo lejimin e kandidimit të saj.

27. Në vijim të detyrës së lënë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, relatori i çështjes ka hartuar relacionin e datës 07.04.2025, duke parashtruar në këtë relacion në mënyrë të përmbledhur: (i) procedurën e zhvilluar, në lidhje me ecurinë e procedurës së kandidimit të kandidates Nurihan Meta (Seiti) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë, në datën 30.09.2024; (ii) propozimin konkret të relatorit të çështjes në lidhje me vijimësinë e kandidimit dhe marrjen e një vendimi përfundimtar. Konkretisht, relatori i çështjes ka propozuar: (i) Të marrë në shqyrtim çështjen me një vendim përfundimtar; (ii) Të vlerësojë dhe konkludojë se nuk ka vend që të vijohet me hetim të thelluar në drejtim të kriterit pasuror, pasi hetimi dhe analizimi i kësaj çështje nga ana e ILDKPI, është i plotë, i mirëarsyetuar, dhe i bazuar në dokumentacionin shkresor të depozituar nga vetë kandidati dhe organet e tjera, të cilët kanë pasur të dhëna në lidhje me pasuritë e hetuara; (iii) Në rastin konkret, mendoj se

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

duhet të merret vendim për ndalimin e kandidimit të Nurihan Meta (Seiti), për shkak të mos kalimit me sukses të kriterit pasuror.

28. Pasi relacioni përfundimtar i çështjes është plotësuar me qëndrimin e relatorit të çështjes, ky relacion i është dërguar për njoftim, kandidates Nurihan Meta (Seiti) në rrugë elektronike në datë 11.04.2025. I njëjti relacion ju është dërguar për njohje dhe vlerësim të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe Avokatit të Popullit.

29. Kandidatja Nurihan Meta (Seiti), pasi është vënë në dijeni të relacionit të datës 07.04.2011, i ka bërë me dije në rrugë elektronike Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në datën 11.04.2025, qëndrimin dhe parashtrimet e saj në lidhje me gjetjet dhe propozimin e dhënë nga relatori i çështjes në lidhje me vijimin e procedurës së shqyrtimit dhe zgjidhjes së çështjes duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto pretendime: *“...Kam vëmendjen dhe përqendrimin maksimal për të dhënë përgjigje në lidhje me të gjitha çështjet e parashtruara dhe për të provuar barrën e provës në këtë gjykim, si një ish-prokurore dhe ish anëtare e KLP. Koha që kam pasur në dispozicion për të pasur një ekspertizë financiare për të kundërshtuar konkluzionet e raportit të hartuar nga ILDKPI, si dhe për të siguruar prova shtresë në mbështetje të pretendimeve të mia. Është i mjaftueshëm fakti se, djali im Rei Meta Nuk ka pasur, nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë pronë në Vlorë, sepse Akti i Deklaruar ishte një akt shkresor falementues që nuk u ekzekutua kurrë nga pala që mori përsipër ndërtimin, sqarim të cilin e kam dhënë në mënyrë të hollësishme. Për këtë arsye, arrij në përfundimin se konkluzionet e dhënë nga ILDKPI janë konkluzione imagjinare të ILDKPI...”*.

30. Gjithashtu, me proces-verbalin e datës 15.04.2025, me nr. 202 Prot. kandidatja Nurihan Seiti ka parashtruar shpjegime shtesë dhe provat shkresore provuese në lidhje me gjetjet e identifikuar në raportin përfundimtar të hartuar nga relatori i çështjes duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se: *“1. Disponoj aktin financiar nga ekonomist licencues për vërtetimin e shumës së bashkëshortit paguar në Dhrami me kursin e lekut shqiptar në vitet 2000-2005 dhe në vitet 1992-1995 të cilat shkojnë në 9,753,842.05 lekë të reja, të cilat tejkalojnë bilancin financiar të hartuar nga ILDKPI; 2. Vërtetimin e lëshuar nga ASHK që im bir Rei Meta nuk ka në pronësi pronë.; 3. Kthim përgjigje nga OSHEE me të cilin vërtetohet se shtetasi Hazis Meta identifikohet si abonent në kontratën e furnizimit të energjisë elektrike të hapur në Tiranë, për herë të parë në datë 19.06.2017, kurdë Nurihan Meta nuk rezulton të ketë kontratë; 4. Kam paraqitur në kontrollin e vitit 2022 pranë ILDKPI, ku nuk kam marrë asnjë rezultat negativ, rreth 200 mandat-pagesa që vërtetonin pagimin e taksave në shumën prej 18,000 dollarë në Bashki dhe në tatim taksa. Këto detyrime i përkisnin punës si avokat me dy firmat e ndërtimit Firmat Ndërtuese A7 dhe IntercoSat; 5. Deklaratën e datës 16.08.2018 për marrjen e çelësit të banesës tek rruga “Shyqëri Bërxolli” ku edhe banojmë; 6. Vërtetim nga BKT që numri i llogarisë rrjedhëse 4010003740SAVAIDALLWD është llogari që merr automatikisht nga paga 10,000 (dhjetë mijë) lekë çdo muaj; 7. Vërtetim nga Universiteti New York për pagesat e fëmijëve që nuk janë 30,000 \$, por 14,000 \$; 8. Kontratë porosie e lidhur midis Hazis Meta dhe Arjan Muca në datë 30.03.2012 për banesën tek “Shyqëri Bërxolli”...; 9. Deklaratë për njohje detyrimi i datës 20.07.2015 midis Hazis Meta dhe Arjan Muca; 10. Dy deklarata noteriale Rei Meta që nuk u ekzekutuan kurrë nga pala premtuese në vitet 2020 dhe 2022; 11. Janë 9 vendime gjyqësore të formës së prerë ku Nurihan e Hazis Meta*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

kanë përfaqësuar banorët tek Shkolla e Kuqe, pjesëmarrje që është bërë pa asnjë pagesë sepse pagesat do të ktheheshin Klering nga Firma Ndërtuese A7 si dhe u kryen ku pagesa prej 18,000 \$ ishte pagesë pune dhe nuk është huadhënie. (bashkëlidhur 9 (nëntë) vendimet gjyqësore).; 12. Gjithashtu, problematike tjetër që hasa ishte se jam paguar ndërmjet Credins Bank për vitet e mia si lektore dhe nuk shoh asnjë bilanc në raport për këto vite. Për të gjitha këto, i kërkoj Këshillit të Emërimeve në Drejtësi si institucion ligjor të ktheni përsëri raportin për korrigjim në ILDKPI... ”.

31. Në mbledhjen e Këshillit, pas relativitetit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates Nurihan Meta (Seiti). Në thelb, Avokati i Popullit parashtrroi se kandidatja Nurihan Meta (Seiti) ka qenë anëtarë e KLP dhe përpara se të zgjidhej në këtë detyrë, i është bërë një kontroll *prima facie* nga komision Ad Hoc i krijuar pranë Avokatit të Popullit. Ky kontroll është bërë nga Avokati i Popullit i mëparshëm dhe në atë procedurë, ai është shprehur se kandidatja nuk e kalon kriterin. Për këtë arsye, është sfidë shumë e madhe dhe është shumë e rëndësishme të theksojmë se verifikimi i kushteve duhet të jetë shumë i kujdesshëm dhe mbi këto kritere.

V. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

1. Verifikimi i kushteve dhe kritereve kushtetuese dhe ligjore të kandidimit

A. Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë së kandidatit dhe familjarëve të tij sipas ligjit.

32. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në interpretim dhe zbatim të dispozitave ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidates Nurihan Meta (Seiti) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30.09.2024.

33. Në shkronjën “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se: “1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte: dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.”.

34. Në nenin 235 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se: “1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë. 2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij. 3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

rezultatet e kontrollit. 4. Me përfundimin e procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar.”

35. Në pikën 30 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, parashikohet se: “Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore”, ndërsa në pikën 51 të po këtij vendimi, parashikohet se: “Këshilli vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë: a) deklarinimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati; b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.”

36. Në pikën 77 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, parashikohet se : “ Ndalimi i kandidatit vendoset në rastet kur ka të dhëna nga burime të ligjshme se kandidati: a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; b) ka fshehur pasurinë dhe të dhënat mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen; c) ka kryer deklarinim të rremë; ç) gjendet në situatën e konfliktit të interesit.”

37. Këshilli vlerëson se, në zbatim të ligjit nr. 115/2016 dhe të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të ndryshuar, ILDKPKI është ngarkuar me kompetenca për kontrollin e pasurisë së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të cilat, i ushtron duke zbatuar edhe rregullat e përgjithshme ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049/2003 mbi afatet, kushtet dhe mënyrën e plotësimit, depozitimit dhe të kontrollit të të dhënave të deklaruara nga subjektet që i nënshtrohen kontrollit të pasurisë dhe interesave private.

38. Në këtë kuptim, ILDKPKI ka edhe kompetencën të verifikojë dhe të konfirmojë zyrtarisht nëse kandidati i përfshirë në listën e dërguar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është paraqitur ose jo për dorëzimin e Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë, nëse është paraqitur dhe e ka dorëzuar këtë Deklaratë brenda afatit 15 ditë për caktuar shprehimisht nga ligji apo nëse e ka plotësuar këtë Deklaratë sipas kërkesave të ligjit në mënyrë që ajo të pranohet për shqyrtim nga ana e ILDKPKI.

39. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Nurihan Meta (Seiti) në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatës Nurihan Meta (Seiti).

40. Këshilli ka konstatuar se në raportin përfundimtar të kontrollit të pasurisë për kandidaten Nurihan Meta (Seiti), ILDKPI në cilësinë e organit ndihmës dhe të angazhuar deri më tani në vlerësimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve sa i takon çështjeve të kriterit pasuror, ka identifikuar rreth 16 gjetje konkrete, të cilat, kryesisht konsistojnë në këto drejtime: (i) mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor; (ii) mospërputhje të deklarimeve; (iii) mosdhënies së sqarimeve të qarta dhe shteruese, si dhe (iv) mosdeklarim i pasurisë së subjekteve të lidhur (djalit të kandidatës) në deklaratat periodike.

41. ILDKPI ka arritur në konkluzion të qartë financiar se: (i) për periudhën nga gusht 1999 - Qershor 2010, si dhe Janar 2014 deri në Janar 2019 nuk ka të dhëna për realizim të ardhurash nga kandidatja Nurihan Meta (Seiti); (ii) për periudhën 26.09.2007 – 08.07.2008 dhe 02.09.2015 – 23.11.2018 kohë në të cilën kandidatja ka qenë e regjistruar me numër unik identifikimi si subjekt tregtar, nuk ka realizim të ardhurash; (iii) nuk justifikohet vlera prej 22,000 USD me të cilën është blerë njësi (e cila ka shërbyer si zyrë), pasi vlera e të ardhurave ka qenë në vlerë më të vogël se blerja e njësisë (Zyrë) shiko konkretisht konkluzionet e ILDKPI në faqen 6 dhe 7 të aktit përfundimtar të kontrollit. Edhe gjatë shpjegimeve shtesë që kandidatja ka dhënë pranë KED, rezulton se nuk janë paraqitur prova shkresore që të përmbysin barrën e provës lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, për të ardhurat e realizuara nga kandidati gjatë periudhës së punësimit dhe të tregojnë se kandidatja dhe familjarët e saj kanë pasur mundësi për të justifikuar blerjen e pasurisë së paluajtshme, njësi në masën prej 22,000 USD.

42. Rezulton se ILDKPI ka konstatuar se kandidati ka pasur mospërputhje të deklarimeve dhe nuk ka dokumentacion shkresor ligjor për provimin e të ardhurave të realizuara, analizë financiare e cila, është identifikuar në mënyrë të qartë dhe shteruese në faqen 6 paragrafi i fundit dhe në faqen 7 të aktit përfundimtar të kontrollit. Në lidhje me këto konstatime të ILDKPI, kandidati nuk ka pasqyruar asnjë kundërshtim apo objeksion, duke mos e përmbysur barrën e provës në lidhje me të ardhurat e realizuara për vitet 2000 deri në 2005, si dhe për të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i kandidatës gjatë kohës që ka qenë në emigrim për periudhën 1990 deri në vitin 2008.

43. Megjithatë, në lidhje me të ardhurat e realizuara nga emigracioni nga bashkëshorti i kandidatës, ILDKPI i ka njohur vlerën prej 3,000,000 (tre milion) lekë të ardhura sipas deklarimit të bërë nga vetë subjekti, duke konsideruar si burim të tyre punën si emigrant në Greqi bazuar në vërtetimet e punëdhënësit grek. Por gjithsesi, këto të ardhura nuk rezultojnë që të provohen në vlerën prej 9,753,842.05 lekë, sikurse ka parashtruar kandidatja, pasi nuk mund të ketë të ardhura totale për të njëjtën periudhë punësimi, në vlera të ndryshme. Pra, të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit në emigrim janë pranuar në vlerën 3,000,000 (tre milion) lekë dhe nuk mund të ndryshojnë, vetëm me pretendimin e kandidatës pa pasur dokumentacion shtesë për to. Për më tepër, provat

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

mbi të cilat kandidatja pretendon vërtetimin e këtyre të ardhurave janë vërtetimi i punonjësit grek, i cili është paraqitur nga kandidatja edhe pranë ILDKPI , e cila i ka vlerësuar në favor të kandidatit sipas shumës së të ardhurave të deklaruara prej vetë asaj.

44. Gjithashtu edhe për shpenzimet e arsimit të fëmijëve në vlerën rreth 30.000 USD ka rezultuar se kandidatja ka paraqitur dokumentacion të pjesshëm justifikues për këto shpenzime me burim të ardhurat familjare, të cilat rezultojnë të pamjaftueshme për përballimin e tyre. Në shpjegimet e saj para Këshillit kandidatja është kontradiktore pasi fillimisht pranon vlerën e shpenzimeve për arsim në shumën prej 30.000 USD që ajo vetë ka deklaruar në ILDKPI , ndërsa në shpjegimet shtesë pretendon vlerën e shpenzuar prej 14.000 USD duke paraqitur, të njëjtin dokumentacion të paraqitur dhe të vlerësuar nga ILDKPI (Vërtetimet nga University of New York Tirana) .

45. Nga analizimi i mbrojtjes së bërë nga ana e kandidatit në lidhje me gjetjet në drejtim të pasurisë, vërehet se kandidati nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me disa nga gjetjet e identifikuar nga ILDKPI, sikurse është mosdeklarimi i të drejtave dhe detyrimeve financiare të djalit Rei Meta, në lidhje me mospërputhjen e sqarimeve dhe deklarimeve që kanë lidhje me pasuri përpara marrjes së detyrës. Në lidhje me këto çështje, Këshilli vlerëson se fillimisht, kandidati ka mbajtur qëndrim tërësisht pasiv dhe nuk ka dhënë asnjë sqarim apo detaj për të identifikuar qëndrimin e tij në lidhje me këto çështje, të cilat, nuk konsiderohen se mund të anashkalohen lehtësisht apo që nuk kanë ndikim në rezultatin përfundimtar për kalimin me sukses dhe në nivel të besueshëm të kriterit pasuror.

46. Në lidhje me mosdeklarimin e detyrimeve financiare të djalit të kandidatit, shpjegimet e dhëna nga kandidati pranë ILDKPI (shiko faqen 26 të aktit të kontrollit, proces-verbalin e datës 22.01.20215), janë të atilla që jo vetëm nuk janë bindëse, por edhe nuk përputhen me kuadrin ligjor të zbatueshëm. Kështu, vlen të theksohet fakti se deklarimi i pasurisë nga personat e lidhur (ku përfshihen edhe fëmijët mbi 18 vjeç), i cili bëhet pjesë e deklaratës së pasurisë së zyrtarit që ka detyrimin për deklarim, plotësohet nga vetë ata, duke lëshuar edhe autorizimin përkatës. Pra, shpjegimi i dhënë nga kandidati se nuk ka qenë në dijeni të veprimeve juridike që kanë pasur si qëllim krijimin pasojave juridike të përfitimit të një pasurie të paluajtshme për djalin e saj Rei Meta nuk është në përputhje me ligjin dhe sjell penalizim në lidhje me këtë kandidim. Ky konstatim rezulton të jetë i tillë, i cili, nuk mund të konvalidohet apo të rregullohet me asnjë shpjegim shtesë apo dokumente shoqërues.

47. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se është i pambështetur dhe nuk justifikohet pretendimi i kandidates se djali i saj Rei Meta nuk disponon pasuri të paluajtshme, e cila nuk ishte e detyrueshme për tu deklaruar në cilësinë e personit të lidhur, pasi rezulton i provuar fakti se djali i saj nuk ka të regjistruar në emër të tij pasuri të paluajtshme në qytetin e Vlorës. Pavarësisht faktit se ky fakt rezulton i vërtetë, Këshilli mban në vëmendje faktin se midis djalit të kandidates Rei Meta dhe subjekteve të treta, janë nënshkruar dy deklarata noteriale në vitin 2020 dhe 2022, të cilat edhe pse aktualisht mund të mos i kenë prodhuar efektet që parashikojnë, ato përbëjnë në vetvete veprime juridike prej të cilave palët kanë pasur si synim që të krijojnë marrëdhënie juridike dhe të cilat janë ende në fuqi, pasi nuk rezultojnë të jenë deklaruar apo anuluar si të pavlefshme.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

48. Kështu, referuar provave të paraqitura nga vetë kandidatja), e konkretisht, deklarata noteriale nr. 395 Rep. dhe nr. 129 Kol, datë 22.04.2020, ka rezultuar i provuar fakti se, palët deklaruese Gazmend dhe Mimoza Begaj ka rënë dakord se: *“...ndërmjetësuesi Rei Meta që ka bërë të mundur realizimin e marrëveshjes mes pronarëve të tokës Gazmend dhe Mimoza Begaj në cilësinë e pronarëve të tokës dhe sipërmarrësit, shoqërisë së ndërtimit “Relt 2000” sh.p.k, do të përfitojë në formën e shpërblimit një vlerë monetare në masën prej 14,000 mijë Euro, të cilat do ti paguheshin në dy këste...”*. Gjithashtu, po në të njëjtën deklaratë noteriale, edhe sipërmarrësi Armando Meshau, administrator i shoqërisë “Relt 2000” sh.p.k ka deklaruar se: *“...nëse kontrata e lidhur me pronarët e tokës Begaj, do të realizohet me sukses, shtetasi Rei Meta do të përfitonte në pronësi të tij një sipërfaqe prej 55 m2 ndërtim dhe 5 m2 sipërfaqe të përbashkëta në katin e parë të banimit...”*.

49. Në analizë të sa më sipër, deklarata noteriale e nënshkruar në datën 22.04.2020, ka pasur si qëllim që shtetasi Rei Meta të krijonte të ardhura në vlerën prej 14,000 Euro, si rezultat i punës së kryer si ndërmjetës dhe nga ana tjetër të përfitonte pronësinë mbi një pasuri të paluajtshme në masën prej 55 m2 ndërtim dhe 5 m2 ambiente të përbashkëta. Për këtë arsye, djali madhor i kandidatës Nurihan Meta (Seiti) ka pasur detyrimin që të bënte deklarin e këtij veprimi juridik, i cili edhe pse nuk i kishte prodhuar pasojat në mënyrë të menjëhershme, kishte si qëllim që ti prodhonte ato pasi të plotësohej kushti ligjor për realizimin e ndërtimit. Gjithashtu, qëllimi i realizimit të përfitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme nga ana e subjektit Rei Meta, saktësohet edhe në deklaratën me nr. 932 Rep dhe nr. 415 Kol, datë 30.06.2022, në të cilën, palët kanë rënë dakord që të shtohet përfitimi në pronësi të shtetasit Rei Meta edhe i një sipërfaqe prej 20 m2, duke u hequr detyrimi që ai do ta paguante këtë sipërfaqe kundrejt të ardhurave të tij prej 7,000 euro, për sa kohë është rritur sasia e ndërtimit që do të kryhej nga ana e shoqërisë sipërmarrëse.

50. Bazuar sa më sipër, në kushtet kur të dy këto deklarata noteriale nuk rezultojnë që të jenë anuluar apo deklaruar të pavlefshme, si dhe në kushtet kur qëllimi i palëve ka qenë që të realizojnë nëpërmjet tyre të ardhura në likuiditete, si dhe të përfitojnë pronësinë mbi një pasuri të paluajtshme, shtetasi Rei Meta kishte detyrimin që ti deklaronte këto veprime juridike si subjekt i lidhur gjatë kohës që kandidatja mbante detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, edhe pse realizimi i këtyre të drejtave do të përfitohej pasi të realizohej kushti i kryerjes së ndërtimit dhe realizimi i të drejtave dhe detyrimeve midis firmës ndërtuese dhe pronarëve të tokës, në cilësinë e ndërmjetësit mes tyre. Prova e re e sjellë nga kandidatja “Vërtetim nga ASHK” sipas të cilës Rei Meta nuk ka asnjë pasuri në emër të tij, tregon gjendjen aktuale të subjektit të lidhur, por shumat e kaluara në llogarinë e tij tregojnë qartësisht se deklaratat noteriale kanë prodhuar efekte, dhe eventualisht do të sjellë efekte dhe mbi sipërfaqet e ndërtimit. Për këtë arsye, shpjegimi i dhënë nga kandidatja se djali i saj nuk e ka realizuar përfitimin e kësaj pasurie dhe për këtë arsye nuk ka pasur detyrim për ta deklaruar, nuk qëndron dhe nuk vjen në përputhje me ligjin për deklarin e pasurive.

51. Sa i takon të gjitha sqarimeve në lidhje me gjetjet e tjera të identifikuar nga ana e ILDKPI, sqarimet e dhëna nga kandidati nuk janë bindëse dhe të atij niveli sa të përmbysin barrën e provës, pra të hedhin poshtë konkluzionet e nxjerra nga ana e organit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

të specializuar të ILDKPI. Kandidati ka pretenduar se ka dërguar dokumentacion shkresor pranë ILDKPI, por në sqarimet e dhëna prej tij nuk ka identifikuar se tek cili dokumentacion shkresor konkret, i depozituar prej tij pranë ILDKPI, është mbështetur për të përmbysur konkluzionin e nxjerrë nga ana e organit që ka kryer hetimin paraprak të pasurisë deri në këtë fazë.

52. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vlerëson të theksojë faktin se, dokumentacioni shkresor që kandidatja ka paraqitur para këtij organi në datën 15.04.2025, sikurse janë 9 (nëntë) vendimet gjyqësore të paraqitura, nuk përbëjnë dokumente shkresore që vërtetojnë të ardhurat nga avokatia për sa kohë, shpenzimet për avokat të evidentuara në këto vendime: (i) janë në vlera të papërfillshme; (ii) nuk rezultojnë të jetë lëshuar faturë tatimore për ofrimin e këtij shërbimi, për të vërtetuar edhe pagimin e detyrimit në organet tatimore. Në këtë rast, që të vërtetohet shërbimi i avokatisë, duhet që kandidatja dhe bashkëshorti i saj në cilësinë e avokatit të lëshojnë faturën tatimore për shërbimin e kryer, të provonte pagimin e detyrimeve tatimore për atë shërbim dhe më pas, të lidhte veprimin juridik se vlera nominale e faturuar nuk është paguar në cash apo në llogarinë bankare të subjektit që ka ofruar shërbimin avokator, pasi kjo vlerë është konvertuar në pasuri të paluajtshme.

53. Në lidhje me raportin financiar nga shërbimet e avokatisë të bashkëshortit të kandidates me subjektin Inter Co-Sat sh.p.k për shlyerjen e apartamentit me sip. 94.98 m², dhe subjektin A-7 sh.p.k për shlyerjen e apartamentit me sip. 63.93 m², ILDKPI ka konstatuar se në të dy rastet detyrimet financiare të faturave tatimore dhe të kontributeve të b/shortit të kandidatit, nuk janë deklaruar në organet tatimore në fund të vitit ushtrimor përkatës 2018, por në vitin 2021. Për sa më sipër, lidhur me burimin financiar për shlyerjen e pasurive të mësipërme, kandidatja nuk ka përmbysur barrën e provës në lidhje me mundësitë financiare të kandidatit dhe b/shortit, (i) për shlyerjen e apartamentit me sip. 94.98 m², në favor të subjektit Inter Co-Sat shpk., gjatë viteve 2015 – 2018, në shumën 41.000 euro, si dhe gjatë periudhës 01.01.2020 – 29.02.2020, në shumën 10.000 euro; (ii) për shlyerjen e apartamentit me sip. 63.93 m² si dhe (iii) për dhënien e huas në shumën 18.000 euro në dt. 15.5.2007 në lidhje me këtë apartament.

54. Në raportin e detajuar të dërguar nga ana e ILDKPI, ky organ për secilën pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të krijuar dhe të disponuar nga kandidati dhe bashkëshorti i saj, ka bërë identifikimin edhe të dokumentacionit shkresor provues që ka paraqitur kandidati, duke bërë një analizë të tyre dhe duke dalë në konkluzion përfundimtar (shiko përmbajtjen e aktit përfundimtar të kontrollit nga faqja 7 deri në faqen 23 të tij). Nuk rezultojnë që në shpjegimet e dhëna kandidati para Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të jetë identifikuar apo të kundërshtuar fakti se, ILDKPI nuk ka evidentuar të gjitha aktet shkresore provuese që kandidatja ka paraqitur pranë saj, duke u prezumuar fakti se dokumentacioni i dorëzuar nga kandidati pranë ILDKPI ka qenë i plotë. Edhe dokumentacioni i paraqitur nga kandidatja pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pasi është njohur me raportin përkatës, nuk është në atë nivel sa të përmbys barrën e provës dhe konkluzionet e arritura nga ILDKPI.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

55. Në këtë mënyrë, bazuar në këtë dokumentacion, si dhe shpjegimet e dhëna nga kandidati nëpërmjet proces-verbaleve përkatëse, pas analizës së detajuar ligjore dhe financiare, serish ILDKPI ka arritur në konkluzionin se ky dokumentacion nuk është i mjaftueshëm për të provuar pretendimet e kandidatit. Për këtë arsye, në kushtet kur kandidatja nuk ka sjellë dokumentacion provues shtesë në lidhje me gjetjet e ILDKPI, pra përtej atij të cituar në aktin e kontrollit përfundimtar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi arrin në konkluzionin se, nuk ka vend që të kryhet një kontroll më i detajuar, pasi kandidati nuk ka më prova shkresore tej atyre që ka depozituar në ILDKPI dhe atyre të paraqitura pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të cilat, të mund të sjellin ndryshimin e rezultatit të përfutur.

56. Gjithashtu, kandidatja nuk ka sjellë asnjë analizë financiare të realizimit të të ardhurave në vite, e cila, të përmbysë rezultatin e arritur nga ILDKPI. shkresa e datës 15.04.2025 nënshkruar nga audituesja ligjore Edlira Buzani nuk përbën analizë financiare. Kjo për faktin se në këtë dokument nuk ka një analizë të të ardhurave të realizuara nga kandidatja dhe familjarët e saj në vite, shpenzimet e kryera për jetesë, shpenzimet e kryera për shkollim apo për blerje të pasurive të paluajtshme për secilin vit kalendarik, me qëllim që të arrihet në përfundimin nëse subjekti dhe familjarë të saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar pasuritë e paluajtshme dhe për të përballuar shpenzimet e jetesës, shkollimit të fëmijëve me të ardhura të ligjshme dhe të njohura nga legjislacioni fiskal tatimor. Vetëm në rast se kandidati do të kishte pasqyruar me parashtrimet e saj pranë Këshillit, një analizë financiare të detajuar dhe të arsyetuar, të cilat do të përmbysnin rezultatin e dhënë nga ILDKPI, Këshilli do të mund të kishte një indicie të arsyeshme për të thelluar hetimin në këtë drejtim.

57. Shpjegimet narrative të dhënë nga kandidati në këtë rast, jo vetëm që nuk e përmbysin barrën e provës dhe konkluzionin e nxjerrë nga ana e organit ndihmës ILDKPI, por ato duket se janë dhënë në kuadrin thjesht për të treguar mosdakordësinë e kandidatit me konkluzionet e arritura dhe jo përmbysjes së këtyre rezultateve dhe provimit se ato janë të gabuara. Gjithashtu, nga ana e kandidatit nuk është pasqyruar dhe nuk është bërë një analizë e detajuar e veprimeve juridike të kryera në kohë nga bashkëshorti i saj në lidhje me pasuritë e krijuara, kuadrit ligjor të mbështetjes së këtyre veprimeve, rendit kronologjik të kryerjes së tyre dhe pasojave të krijuara.

58. Pra, në tërësi sjellja e kandidatit në dhënien e përgjigjeve për çështjet që i janë adresuar, është kufizuar vetëm me kthimin e përgjigjeve dhe vënien në dispozicion të provave shkresore, pa bërë një analizë të detajuar juridike dhe financiare, të atij niveli sa të përmbysin gjetjet e konstatuara nga ILDKPI. Për këtë arsye, Këshilli arrin në konkluzionin se, nuk ekziston asnjë indicie e bazuar që ky organ të vijojë shqyrtimin e thelluar të gjetjeve në kriterin pasuror, për sa kohë arsyetimi dhe analizimi i dhënë nga ILDKPI në aktin përfundimtar është dukshëm i pranueshëm, i arsyetuar dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

59. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Nurihan Meta (Seiti) nuk ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, dhe pikës kjo kandidate gjendet në kushtet e ndalimit të kandidatit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

60. Bazuar në aktet që përmban dosja e kandidatit të analizuar me sipër në këtë vendim, parashtrimeve dhe pretendimeve të paraqitura nga kandidatja Nurihan Meta (Seiti), konkluzioneve përfundimtare të dhëna nga ILDKPI në akt-kontrollin përfundimtar si dhe dokumentacionin mbi të cilin është bazuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbështetje të pikës 4 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe të shkronjës “a” të pikës 78 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidates Nurihan Meta (Seiti) në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30.09.2024.

61. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Nurihan Meta (Seiti) nuk ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikës 77 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, kjo kandidate gjendet në kushtet e ndalimit të kandidatit për sa i përket verifikimit të pasurisë, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

62. Bazuar në aktet që përmban dosja e kandidatit të analizuar me sipër në këtë vendim, parashtrimeve dhe pretendimeve të paraqitura nga kandidatja Nurihan Meta (Seiti), konkluzioneve përfundimtare të dhëna nga ILDKPI në akt-kontrollin përfundimtar si dhe dokumentacionin mbi të cilin është bazuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbështetje të pikës 4 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe të shkronjës “a” të pikës 78 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidates Nurihan Meta (Seiti) në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30.09.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/c të ligjit nr. 8577/2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, si edhe pikave 30, 51, 52, 61, 62 dhe 77 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidates Nurihan Meta (Seiti), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30.09.2024.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Nurihan Meta (Seiti).
3. Kandidatja Nurihan Meta (Seiti) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ANËTAR

Zv/KRYETARE

KRYETAR

Ilir TOSKA

Marjana SEMINI

Sokol SADUSHI

ANËTARE

ANËTARE

ANËTARE ZËVENDËSUESE

Enkela VLORA

Nafije HASKO

Elvana ÇIÇOLLI

ANËTARE

ANËTARE

ANËTAR

Alma MUÇA

Irma BALLI

Etien KAPO

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**